



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:047248

Datë: 20.05.2022

Numri i dokumentit: 03037473

PKR.nr.67/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, me Kryetarin e Trupit Gjykes – Gjykatësi **Drilon Haraçia**, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, kundër të akuzuarit A. (P.) P. nga fsh.R., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër PP/I.nr.68/2022 të datës 21.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **20.05.2022**, në prezencën e Prokurores së Shtetit Dëshire Jusaj, si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

A. P., i biri i P., nënës D., e gjinisë H., i lindur më 24.01.1996, në Gjakovë, tani me banim në fshatin R., Komuna e Gjakovës, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë-bujk, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:

Ë S H T Ë F A J T O R

I.Sepse me datë të pacaktuar e deri me dt.28.12.2020 në shtëpinë e axhës së tij në Gjakovë, rr. “G. B.” në cilësinë e mbikëqyrësit të shtëpisë ka mbajtur pa dijeninë e axhës P. P. dhe familjarëve të tij që jetojnë përkohësisht prej vitesh në Zvicër, armë në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve dhe në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-022 për armët, armën e tipit AK-47, të prodhimit Kinez me nr. Serik: me një karikator dhe 24 fishek të kalibrit 7.62×39mm, një revole e markës TT, me nr. Serik me një karikator, një revole të markës Glock të prodhimit Austriak me nr. Serikme një karikator dhe dy fishekë të kalibrit 7.65mm, 113 copë fishekë të kalibrit 7.62×39mm, 2 copë fishekë të kalibrit 7.62mm, 1 karikator të armës së shkurtër, dhe 1 këllëf për revole të shkurtër, të cilat pas bastisjes së realizuar policore dhe gjetjes së tyre në mënyrë të kundërligjshme nga veprimet e të pandehurit armët e lartcekura i konfiskohen nga policia.

- **Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, dhe nenit 366 par.1 dhe 3 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e tij, konform nenit 44 të KPRK-së, **I ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 4.000.00 € (katërmijë) Euro, ku i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse e akuzuari Arben Pepaj, nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në shumën prej 4.000.00 € (katërmijë) Euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **atëherë dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 200 (dyqind) ditëve**, duke ia llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Ndaj të akuzuarit A. P., bëhet konfiskimi i: një (1) armë e tipit AK-47, të prodhimit Kinez me nr. serik: 11124331 me një karikator dhe 24 fishek të kalibrit 7.62×39mm, një (1) revole e markës TT, me nr. serik J-129934 me një karikator, një (1) revole të markës Glock të prodhimit Austriak me nr. serik ZRAGY02#181200239 me një karikator dhe dy fishekë të kalibrit 7.65mm, 113 copë fishekë të kalibrit 7.62×39mm, 2 copë fishekë të kalibrit 7.62mm, 1 karikator të armës së shkurtër, dhe 1 këllëf për revole të shkurtër, si objekte të kryerjes së veprës penale.

Detyrohet e akuzuari A. P., që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 50 (pesëdhjete) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 50 (pesëdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.68/2022 të datës 21.04.2022, kundër të akuzuarit A. (P.) P. nga fsh.Ramoc, Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë akuzës duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

I akuzuari A. P. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, deklaroi se jam penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, po ashtu shton se është hera e parë që ballafaqohem me drejtësinë, i premtojë gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale, lus gjykatën që t' më shqiptojë një dënim sa më të lehtë, tjetër nuk kam se çka të shtojë.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, ka deklaruar se i akuzuari A. P. në këtë shqyrtim fillestar e pranojë fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës, ashtu duke qenë të bindur se ky pranim i fajësisë së bërë nga ana e tij është bërë me vullnet dhe pa presion. Ky pranim i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e propozuara në aktakuzë kështu që i propozojë KTGJ që këtë pranim të fajësisë nga ana e të akuzuarit ta aprovojë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se e akuzuari A. P., me dashje ka kryer mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”.

5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarin A. P., e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës, ngase në veprimet e të akuzuarit si në dispozitivin të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit A. P.: në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, jeton vet i pesti në familje dhe merren me bujqësi, faktin se është i gjendjes së mesme ekonomike. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilat ngarkohet. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti pasi që e njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, mirëpo morri parasysh sasinë dhe llojin armëve dhe sendeve të tjera të cilat janë konfiskuar. Ndërsa duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Kryetari i Trupit Gjykues, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit A. P., dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, e ka zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 4.000.00 € (katërmijë) Euro, duke i marrë për bazë rrethanat e lartcekura.

8. Konfiskimi

Gjykata ndaj të akuzuarit A. P., konform neneve 366 par.3 të KPRK-së, ka bërë konfiskimin e: një (1) armë e tipit AK-47, të prodhimit Kinez me nr. serik: me një karikator dhe 24 fishek të kalibrit 7.62×39mm, një (1) revole e markës TT, me nr. serikme një karikator, një (1) revole të markës Glock të prodhimit Austriak me nr. serikme një karikator dhe dy fishekë të kalibrit 7.65mm, 113 copë fishekë të kalibrit 7.62×39mm, 2 copë fishekë të kalibrit 7.62mm, 1 karikator të armës se shkurtër, dhe 1 këllëf për revole të shkurtër, si objekte të kryerjes se veprës penale.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.67/22, me datë 20.05.2022

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.